

# KIRFN Interpretimi 10

## Raportimi Financiar i Ndërmjetëm dhe Çvlerësimi

### Referencat

---

- SNK 34 *Raportimi Financiar i Ndërmjetëm*
- SNK 36 *Çvlerësimi i Aktiveve*
- SNK 39 *Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja*

### Informacion Bazë

---

- 1 Një njësi ekonomike i kërkohet të vlerësojë emrin e mirë për çvlerësimin në cdo datë raportimi, të vlerësojë investimet në instrumentat e kapitalit dhe në aktivet e saj financiare të mbajtura me kosto për cvlerësim në çdo datë raportimi dhe, nëse kërkohet, i kërkohet të njohë një humbje nga cvlerësimi në këtë datë në përputhje me SNK 36 dhe SNK 39. Megjithatë, në një datë bilanci të mëpasshëm apo datë raportimi të mëpasshëm, kushtet mund të kenë ndryshuar ashtu sa që humbja nga cvlerësimi mund të pakësohet apo mënjanohet nëse vlerësimi i cvlerësimit të bëhet vetëm në këtë datë. Ky Interpretim siguron udhëzim nëse humbje të tilla nga cvlerësimi duhet ndonjëherë të anulohen.
2. Interpretimi merret me bashkëveprimin midis kërkesave të SNK 34 dhe njohjes se humbjeve nga cvlerësimi në emrin e mirë në SNK 36 dhe disa aktive financiare në SNK 39, dhe efektin e këtij bashkëveprimi në pasqyrat financiare të ndërmjetme dhe vjetore të mëpasshme.

### Çështje

---

- 3 SNK 34, paragrafi 28 kërkon që një njësi ekonomike të zbatojë të njëjtat politika kontabël në pasqyrat e ndërmjetme financiare të saj ashtu si janë aplikuar në pasqyrat financiare vjetore të saj. Ajo gjithashtu konstaton se “shpeshësia e raportimit të një njësi ekonomike (vjetor, gjashtëmuor, apo tremuor) nuk do të ndikojë në matjen e rezultateve të saj vjetore. Për të arritur këtë objektivë, matjet për qëllime të raportimit të ndërmjetëm do të bëhen mbi një bazë “që nga fillimi i vitit deri në momentin aktual”
- 4 SNK 36, paragrafi 124 përcakton se ‘Një humbje nga cvlerësimi e njohur për emrin e mirë nuk do të anulohet në një periudhë të mëpasshme’
- 5 SNK 39 paragrafi 69 konstaton se ‘Humbja nga cvlerësimi e njohur në fitim apo humbje për një investim në një instrument të kapitalit neto të klasifikuar si të vlefshëm për shitje nuk do të anulohet nëpërmjet fitimit apo humbjes .
- 6 SNK 39 paragrafi 66 kërkon që humbjet nga cvlerësimi për aktivet financiare të mbajtura me kosto (të tillë si një humbje nga cvlerësimi në një instrument kapitali të vet të pakuotuar e cila nuk është mbajtur me vlerën e drejtë sepse vlera e tij e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme) nuk duhet të rimerret.
- 7 Interpretimi merret me çështjen e mëposhtme:

A duhet një njësi ekonomike të rimarrë humbjet nga cvlerësimi të njohura në një periudhë të ndërmjetme në emrin e mirë dhe investimet në instrumentet e kapitalit dhe në aktivet financiare të mbajtura me kosto nëse nuk është njohur humbje apo është njohur një humbje më e vogël, të ketë një vlerësim të cvlerësimit të bërë vetëm në një datë të bilancit të mëpasshëm?

### Marrëveshje

---

- 8 Një njësi ekonomike nuk do të rimarrë një humbje nga cvlerësimi të njohur në një periudhë të mëparshme të ndërmjetme në lidhje më emrin e mirë apo një investim si në një instrument të kapitalit apo në një aktiv financiar të mbajtur me kosto.
- 9 Një njësi ekonomike nuk do të zgjerojë këtë marrëveshje për analogji, në fusha të tjera me konflikt të mundshëm midis SNK 34 dhe standarteve të tjera.

## **Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare**

---

- 10 Një njësi ekonomike do të zbatojë Interpretimin për periudhat që fillojnë më ose pas datës 1 Nëntor 2006. Zbatimi më i hershëm inkurajohet. Nëse një njësi ekonomike zbaton Interpretimin për një periudhë që fillon para 1 Nëntor-it 2006, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt. Një njësi ekonomike do të zbatojë Interpretimin për emrin e mirë në të ardhmen që nga data në të cilën ajo ka aplikuar për herë të parë SNK 36; Ajo do të zbatojë Interpretimin për investimet në instrumentat e kapitalit apo në aktivet financiare të mbajtura me kosto për të ardhmen që nga data në të cilën ajo ka aplikuar për herë të parë kriterin e matjes të SNK 39.